LIGJ
Nr. 127/2012

PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT TË PARË TË MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN, ADMINISTRIMIN, SIGURINË, FINANCIMIN DHE PLOTËSIMIN ME EKIP TË QENDRËS SË NATO-S PËR BASHKËRENDIMIN E OPERACIONEVE SPECIALE (NSCC)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 e 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi i parë i memorandumit të mirëkuptimit për krijimin, organizimin, administrimin, sigurinë, financimin dhe plotësimin me ekip të Qendrës së NATO-s për Bashkërendimin e Operacioneve Speciale (NSCC), sipas tekstit bashkëlidhur.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.12.2012

Shpallur me dekretin nr.7923, datë 11.1.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

AMENDAMENTI I PARË I MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT (MiM) NDËRMJET DEPARTAMENTIT TË MBROJTJES TË SHTETEVE TË BASHKUARA DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DHE MINISTRIT TË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË BELGJIKËS, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË BULLGARISË, DHE DEPARTAMENTIT TË MBROJTJES KOMBËTARE TË KANADASË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË ÇEKISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË DANIMARKËS, DHE MINISTRIT TË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË FRANCËS DHE MINISTRISË FEDERALE TË MBROJTJES TË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË GREQISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË HUNGARISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË ITALISË, DHE MINISTRISË TË MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË LETONISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË LITUANISË, DHE MINISTRIT TË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË HOLANDËS, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË NORVEGJISË, DHE MINISTRIT TË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË POLONISË, DHE MINISTRIT TË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË PORTUGALISË, DHE MINISTRISË RUMUNE TË MBROJTJES KOMBËTARE, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SLLOVAKISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË SPANJËS, DHE SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË

REPUBLIKËS SË TURQISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT, DHE SHTABIT TË PËRGJITHSHËM SUPREM TË FUQIVE ALEATE EUROPIANE (SHAPE) LIDHUR ME KRIJIMIN, ORGANIZIMIN, ADMINISTRIMIN, SIGURINË, FINANCIMIN DHE PLOTËSIMIN ME EKIP TË QENDRËS KOORDINUESE TË OPERACIONEVE SPECIALE TË NATO-S

Në përputhje me seksionin XVIII të memorandumit të mirëkuptimit, nënshkruesit në këtë mënyrë ndryshojnë memorandumin e mirëkuptimit si më poshtë:

1. Të gjithë termat në këtë dokument mbartin të njëjtin kuptim, ashtu siç parashikohen në memorandumin e mirëkuptimit.

2. Zëvendësoni frazën "Qendra e Koordinimit të Operacioneve Speciale të NATO-s" përgjatë memorandumit të mirëkuptimit me "Shtabi i Operacioneve Speciale të NATO-s". Në të njëjtën mënyrë zëvendësoni inicialet "NSCC" përgjatë memorandumit të mirëkuptimit me inicialet "NSHQ", përveç kur konteksti kërkon që inicialet të mbeten "NSCC".

3. Zëvendësoni termin "drejtor" me termin "komandant" përgjatë memorandumit të mirëkuptimit.

4. Në paragrafin e pestë hyrës, nën titullin "Hyrje" zëvendësoni fjalët "nëpërmjet përmirësimit" me fjalët "përmirësimi i" para "aftësive për pajisje" në fund të fjalisë së fundit.

5. Në paragrafin e dhjetë hyrës, nën titullin "Hyrje", hiqni të gjithë paragrafin dhe zëvendësojeni atë si më poshtë:

"Duke vërejtur se NATO MCN-423-2009 "Riorganizmi i Qendrës së Koordinimit të operacioneve speciale të NATO-S (NSCC) si Shtabi i Operacioneve Speciale të NATO-s (NSHQ) 8 shtator 2009. Komiteti ushtarak i NATO-s mbështeti riorganizimin e NSCC-së si NSHQ".

6. Në paragrafin e njëmbëdhjetë hyrës nën titullin "Hyrje", hiqni të gjithë paragrafin dhe zëvendësojeni si më poshtë:

"Duke vërejtur marrëveshjen teknike ndërmjet SHAPE-it dhe Departamentit të Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara lidhur me komandimin dhe kontrollin e NSCC-së nga NATO-ja të ndryshuar për të mbuluar masat e komandimit dhe të kontrollit për NSHQ-në".

7. Hiqni plotësisht paragrafin e trembëdhjetë hyrës nën titullin "Hyrje", që përbëhet nga fjalia "duke vërejtur që NSCC është një qendër koordinuese dhe këshilluese pa funksione komanduese".

8. Hiqni plotësisht paragrafin 1.3.

9. Hiqni plotësisht paragrafin 2.2 dhe zëvendësoheni me sa më poshtë:

"2.2 Qëllimi i këtij memorandumi mirëkuptimi bazohet në konceptin e iniciativës transformuese të Forcave Speciale Operacionale të NATO-s (NSTI) me NSHQ që zëvendëson NSCC si qendër e iniciativës transformuese (NSTI). Ky koncept ishte baza e MCM-143-2006, MCM-190-2006. MCM-0069-2008 dhe MCM-0123-2009. Qëllimi i memorandumit të mirëkuptimit mbështet rolin e NSHQ si një organizatë shumëkombëshe me një marrëdhënie komanduese të përhershme me SACEUR dhe aftësi për të ushtruar komandim dhe kontroll mbi NATO SOF (Forcat Speciale Operacionale të NATO-s) në nivel komponenti mbas transferimit të autoritetit, bazuar në përvojën e gjatë dhe burimet e Forcave Speciale Operacionale për të mundësuar trajnimin dhe përdorimin e tyre; sinkronizimin e Forcave Speciale Operacionale përgjatë Aleancës NATO në bashkëpunim me SHAPE. Komandat e forcave të përbashkëta (JFCs), si dhe entitetet kombëtare të Forcave Speciale Operacionale me qëllimin final të sigurimit të unitetit të përpjekjes së Forcave Speciale Operacionale të NATO-s. Memorandumi i mirëkuptimit mbështet aftësinë e NSHQ-së për të integruar planifikimin e Forcave Speciale Operacionale të NATO-s, për të siguruar një politikë dhe doktrinë të përbashkët të kombinuar të Forcave Speciale Operacionale, për të mbështetur procesin e gjenerimit të forcës të Forcave Speciale Operacionale të NATO-s dhe për të përmirësuar ndërveprimin e forcave të pjesëmarrësve".

10. Hiqni tekstin e paragrafit 3.1 dhe përfshini si më poshtë:

"a) NSHQ-ja mbetet pika kryesore e zhvillimit, drejtimit dhe koordinimit për të gjitha aktivitetet që lidhen me operacionet speciale të NATO-s, me qëllim optimizimin e përdorimit të Forcave Operacionale Speciale për të përfshirë sigurimin e një aftësie operacionale komanduese kur drejtohet nga

SACEUR-i.

b) NSHQ-ja mundëson sinkronizimin e Forcave Operacionale Speciale në të gjitha vendet e NATO-s, kontribuon në unitetin e përpjekjeve të Forcave Operacionale Speciale të NATO-s dhe siguron për SACEUR-it një planifikim të operacioneve ekspeditore shumëkombëshe dhe aftësinë e komandimit dhe kontrollit për përdorim në një mision të aleancës, sipas udhëzimeve".

11. Hiqni plotësisht paragrafin 3.2 dhe zëvendësojeni me:

"NSHQ-ja ngarkohet drejtpërsëdrejti dhe posaçërisht nga SACEUR-i në përputhje me procedurat e NATO-s. Marrëdhëniet vartëse dhe marrëdhëniet e komandimit që mundësojnë NSHQ-në të kryejë detyrat e saj në kohë paqeje, krize dhe operacionet do të realizohen në përputhje me dispozitat e marrëveshjes teknike ndërmjet Departamentit të Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe SHAPE. SHAPE do të konsultohet me pjesëmarrësit para çdo ndryshimi të marrëveshjes teknike".

12. Hiqni plotësisht paragrafin 4.2 dhe zëvendësoheni si më poshtë:

"Statusi i Shtabit të Përgjithshëm Ndërkombëtar Ushtarak (IMHQ) i parashikuar nga Protokolli i Parisit dhe çdo marrëveshje plotësuese dhe implementuese e Protokollit të Parisit sipas vendimit të Këshillit të Adriatikut Verior (NAC) mbi shpërndarjen e NSCC dhe aktivizimin e NSHQ-së si trupi ushtarak i NATO-s nëpërmjet PO (2009)-0135, 24 shtator 2009.".

13. Përfshini paragrafin e ri 7.8:

"Të gjithë anëtarët e stafit të NSHQ-së janë të përshtatshëm për angazhim dhe detyra të përkohshme sipas përshkrimit të detyrave të tyre, në varësi të ligjeve dhe rregulloreve kombëtare dhe me miratim të NMR-së ose SNR-së përkatëse në emër të pjesëmarrësit.".

14. Hiqni plotësisht paragrafin 12.4.

15. Në rreshtin e shtatë të paragrafit 16.1 hiqni fjalët "nënshkruesit" dhe zëvendësoheni me fjalën "pjesëmarrësi".

16. Në rreshtin e parë të paragrafit 18.2, zëvendësoni termin "NSC" me "struktura komanduese të NATO-s".

Ky amendament i parë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të fundit si më poshtë. Ky amendament i parë hartohet në gjuhën angleze në një kopje origjinale. Kopje të njësuar me origjinalin do t'i sigurohen secilit pjesëmarrës të NSHQ-së nga ana e SHAPE-s.